



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0299

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Batisha Ibrahimimi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE “ALLTON SH.P.K”, kundër njoftimit për kontratë ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – LOTO 1 dhe LOTO 2” me numër të prokurimit 616-24-1099-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna e Prishtinës”, më 19/06/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “ALLTON” SH.P.K. me nr. 2024/0299, e datës 05/04/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – LOTO 1 dhe LOTO 2”, me numër të prokurimit 616-24-1099-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

2. **Anulohet** njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – LOTO 1 dhe LOTO 2”, me numër të prokurimit 616-24-1099-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna e Prishtinës”. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsytiveve të dhëna nga paneli shqyrtues dhe konform nenit 53 të LPP., të zgjas afatin kohor për ofertim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

5. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 15.02.2024, “Komuna e Prishtinës”, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – LOTO 1 dhe LOTO 2”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës **1,496,200.00 €**.

Me 24.03.2024, OE “ALLTON SH.P.K” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 28.03.2024, Autoriteti Kontraktues e ka aprovuar si pjesërisht e bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 05.04.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “ALLTON SH.P.K” me nr. 299/24 lidhur me aktivitetin “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – LOTO 1 dhe LOTO 2” me numër të prokurimit 616-24-1099-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ALLTON SH.P.K” janë parashtruar si në vijim:

Të pa kënaqur me Vendimin e AK “Komuna e Prishtinës” ku e miraton si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – LOTO 1 dhe LOTO 2”, me nr te prokurimit: 616- 24-1099-2-1-1 dhe nr. të brendshem 616 -24-09-2-1-1, brenda afatit ligjor, ushtrojmë këtë ankesë pranë OSHP-së:

Autoriteti Kontraktues është dashur t’a pezulloje aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – LOTO 1 dhe LOTO 2”, me nr. të prokurimit: 616-24-1099-2-1-1 dhe nr. të brendshem 616 -24-09-2-1-1, me rastin e kërkesës për rishqyrtim, mirëpo AK nuk e ka bërë pezullimin e aktivitetit të prokurimit ku me këtë rast ka shkelur nenin 6 të LPP-së, ku thotë se citat: “6.1 Ushtrimi i kërkesës për rishqyrtim automatikisht pezullon procedurën e prokurimit dhe ne këtë rast Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, duhet te njoftoj me shkrim te gjitha palët e interesuara lidhur me pezullimin e procedurës se prokurimit ne fjalë”

Pastaj, AK tek arsyetimi e ka ngatërruar kërkesën për rishqyrtim, sepse AK ka thënë: “OE ALLTON SHPK, tutje parashtruesi me datën 24.03.2024 ka paraqitur kerkese për rishqyrtim, kundër njoftimit për kontrate në dosjen e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ‘Furnizimi dhe pajisjet teknologjike (IT Shkence) për kabinetin në IEAA’ me nr. te prokurimit 616-23-9220-1-1-1”.

Ky arsyetim ska të bëjë absolutisht asgjë me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – LOTO 1 dhe LOTO 2”, me nr. të prokurimit: 616-24-1099-2-1-1. AK, në vendimin e datës 27.03.2024 e miraton si pjesërisht të bazuar kërkesën tonë për rishqyrtim të datës 24.03.2024, mirëpo manipulon duke thënë se kemi bërë korrigjimin në dosjen e tenderit në lidhje me pretendimet tona. AK nuk ka bërë asnjë korrigjim në lidhje me pretendimet tona përpos tek pretendimi 3.

Pretendimi 1 i OE “ALLTON” SH.P.K ka qenë: “Keni kërkuar një listë të kontratave të realizuara duke plotesuar aneksin 4 të dosjes së tenderit, mos është fjala për aneksin 6, sepse aneksi 4 është Siguria e Tenderit. Gjithashtu, keni kërkuar tek kriteret, pika 7, kërkesa juaj është që Operatori Ekonomik me rastin e dorëzimit të ofertës të paraqes një Analizë Financiare me

pagë bruto 400€ për punëtorë sipas ATK dhe pushimeve vjetore sipas Ligjit të Punës. Pyetja jonë është se a është fjala për Ligjin e Punës nr.03/L-212.”

Sa i përket këtij pretendimi AK as që u marrë me këtë pretendim, nuk kemi marrë asnjë përgjigje. AK ka kërkuar një kontratë të realizuar, duke kërkuar plotësimin e aneksit 4 te dosjes se tenderit, ndërsa ne e kemi pyetur se mos është fjala për aneksin 6 sepse aneksi 4 është Siguria e Tenderit. Gjithashtu, AK tek kriteret pika 7 ka kërkuar një analizë financiare me pagë bruto 400€ për punëtorët sipas ATK dhe pushimeve vjetore sipas Ligjit të Punës. Pyetja jonë ka qenë se a është fjala për Ligjin e Punës nr.03/L-212. Pra, në këtë pretendim nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

Pretendimi nr.2 kemi kërkuar: “Vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit LOT 1 është shumë më e vogël se sa kërkesat e paraqitura në FDT. Pra, ne shkurtimisht po e elaborojme këto analize financiare sipas kërkesave të DT.”

Pagat e punëtorëve me të gjitha tatimet sipas Ligjit të Punës nr.03/L-212 dhe skemës së ATK-së $140(\text{punëtorë}) * 400\text{€ (paga bruto)} = 56,000\text{€ (bruto)}$ 5% (kontributi i punëdhënësit), $140 * 20 = 2,800\text{€}$, që do të thotë vetëm pagat pa llogaritur pushimet vjetore, materialin, tvsh dhe stazhin e punës janë të barabarta me 58,800€. Pra, kësaj shume kur t’i shtohen edhe pushimet vjetore rreth 5,000€, materiali rreth 2,000€ si dhe stazhi i punës së paku rreth 3,000€ është e barabartë $68,800\text{€} * 18\% (\text{tvsh}) = 12,384\text{€} = 81,184\text{€}$ paga mujore për të gjithë punëtorët e kërkuar. Kur shuma 81,184 shumëzohet me 18 muaj është e barabartë 1,461.312.00 euro.

Pra, sipas kërkesave të cilat ju i keni paraparë sipas DT, vlera e parashikuar për LOT 1 duhet të jetë gati rreth 1,500.000€. Ndersa, ju keni paraparë 1,174.000€ gjë e cila është e pamundur të realizohet kontrata. Kërkojmë nga ju ose të zvoglohen kërkesat e dosjes apo numëri i punëtorëve ose që të rishikohet edhe një herë vlera e parashikuar të cilën e keni paraparë ju si AK dhe kjo vlerë të rritet konform kriterëve të dosjes së tenderit.” Mirëpo, edhe për këtë pretendim nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

Pra, tek ky pretendim kemi të bëjmë me vlerën e parashikuar të kontratës për këtë aktivitet të prokurimit për LOT 1, që është shumë më e vogël se sa kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit.

Tek pretendimi nr. 3 kemi kërkuar: “Tek kriteret e dosjes se tenderit “Kërkesat mbi mundesine teknike dhe/ose profesionale” keni kërkuar ISO Certificate 45001 2018 dhe si deshmi per kete ISO eshte kërkuar kopje e certifikates ISO 14001-2015 po ashtu gabim i njejte eshte edhe tek ISO 14001 2018 ku si deshmi per kete eshte kërkuar kopje e certifikates ISO 4500:2018.” Tek ky pretendim AK e ka bërë korrigjimin e dosjes së tenderit.

Tek pretendimi nr.4 kemi kërkuar: “LOT 2 - Vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit për LOT 2 është më e vogël se sa kërkesat e paraqitura në DT. Pra, ne shkurtimisht përmes një analize financiare të cilën e kemi llogaritur konform kriterëve të DT, po ua elaborojmë shkurtimisht. Pagat e punëtorëve me të gjitha tatime sipas Ligjit të Punës nr. 03/L-212, skemës së ATKsë për 51 (punëtorë) * 400 (paga bruto) = 20,400€ (bruto) 5% (kontributi i punëdhënësit), 51 (punëtorë) * 20 = 1,020€, që do të thotë se vetëm pagat pa llogaritur pushimet vjetore, materialin, tvsh, stazhin e punës dhe fitimin janë 21,420€, pra kësaj kur t'i shtohen edhe pushimet vjetore rreth 1,800€, materiali rreth 1,400€ si dhe stazhi i punës rreth 1,000€ është e barabartë 25,620€ * 18% (tvsh) = 4,611.6€ = 30,231.6€. Pra, kur shuma prej 30,231.6 * 18 = 544,168.8€ që do të thotë rreth 550,000€ Pra, sipas kërkesave të cilat ju i keni paraparë në DT, vlera e parashikuar për LOT 2 është rreth 550,000€, ndërsa ju si AK keni paraparë shumën prej 388,800€.”

Pra, edhe tek ky pretendim kemi të bëjmë me vlerën e parashikuar të kontratës për këtë aktivitet të prokurimit për LOT 2, që është shumë më e vogël se sa kërkesat e paraqitura ne dosjen e tenderit. Në bazë të kërkesave të dosjes dhe numrit minimal obligativ të punëtorëve, vlera e parashikuar si për Lot 1 poashtu edhe për Lot 2 është e pamjaftueshme, andaj kërkojmë nga ju që të ri-shiqohet edhe njëherë buxheti, sepse, me këtë buxhet është e pamundur të realizohet kontrata me këto kërkesa.

Po ashtu tek pretendimi nr.4 pika 1 kemi kërkuar: “ Keni kërkuar një menaxher me përvojë pune së paku 5 vite, me pagë mujore 500€ të përfshihet në analizën financiare dhe të dëshmohet me trust pensional dhe kontratë pune. Pyetja jonë është se çfarë kualifikimi (fakulteti) që duhet të ketë menaxheri për këtë aktivitet të prokurimit si dhe paga mujore a duhet të jetë 500€ neto apo bruto sepse nuk e keni cekur.” Edhe për këtë kërkesë nuk kemi marrë asnjë përgjigje lidhur me kualifikimin e menaxherit.

Gjithashtu tek pretendimi nr.4 pika 2 kemi kërkuar: Tek lista e pajisjeve Aneksi 7, tek pika nr.2 keni kërkuar minimumi 40 fshesa elektrike, Makina per larjen e dyshimeve minimum 8 copa, trimera me derivate minimum 70 cope, kositese per kopsht me derivate minimum 30 ,sasia kaq e

madhe e ketyre kërkesave eshte e pa nevojshme, duke pasur eksperinca qe një kohë të gjatë me pastrimin e shkollave. Përveç kësaj ju lutem te specifikoni qartë sasinë e kërkuar tek ankesi 7. Nëse i referohemi vlerës se parashikuar te kontrates per lot 1 dhe lot 2 është totalisht e pakutueshme se si jane kërkuar keto sasia kur dihet se vlera e parashikuar per lot 2 eshte rreth 3 here me e vogël se sa vlera e parashikuar per lot 1 kurse sasi të janë kërkuar në numër të njëjtë. Kjo pyetje vlenë për të gjitha sasi të e parapara tek aneksi 7 i dosjes sepse nuk jane te specifikuar sa jane per LOTO 1 dhe sa jane per LOTO 2 kur dihet mire se LOTO 2 eshte rreth 3 here me i vogël se sa vlera e parashikuar per LOTO 1 duke u bazuar ne vleren e parashikuara ne DT. Kerkojme nga Paneli Shqyrtues i Prokurimit qe te detyroj AK qe te na e specifikoj per secilen Loto sasin e kerkuar pasi qe lotot nuk jane ne proporcion te barabart ne mes veti.

Pretendimi nr.4 pika 3 kemi kerkuar: “Tek pika nr.7, keni kërkuar një kran me lartësi minimumi 30 metra, duke pasur parasysh se objektet shkollore maksimumi janë 2-4 kat, mendojmë se kjo kërkesë është shumë e lartë dhe kërkojmë nga ju që kranin për pastrim të mos kufizohet në 30 metra por të jetë më i vogël. Siç vërehet edhe kjo kerkese e dosjes paraqet kufizim te konkurrencës andaj kërkojm që kjo kërkesë ose të hiqet ose të zvoglohet minimumi i kerkuar në 20 metra sepse minimumi i kërkuar prej 30 metra shërben vetëm për objekte prej 14 kate e më lartë. Po ashtu kjo kërkesë eshte ne kundërshtim me nenin 51 te LPP-se andaj ose përshtatni me natyren e kontrates ose ta heqni krejtësisht si te tillë sepse objektet e shkollave maksimum janë 2-4 kate dhe lartësia prej (minimum 20 metrave) jo që është e mjaftueshme por teper e gjate.”

Pretendimi nr.4 pika 4 kemi kerkuar: “Tek pika nr.8, keni kërkuar platformë apo pajisje ngjitëse për pastrimin e xhamave në lartësi minimumi 32 metra, me gjerësi deri 1.30 m përiçeve minimum 7. Kjo kërkesë është komplet e panevojshme, sepse, pjesa më e madhe e shkollave janë maksimumi 2-4 kate. Pra, të gjitha dritaret që janë të parapara mund të pastrohen edhe me anën e kranit. Ju lutemi që këtë kërkesen ta heqni nga dosja pasi që është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe favorizon vetëm një OE. Ju vë në dijeni se kerkesa 8 është plotësisht në kundërshtim me nenin 51 te LPP-se sepse është krejtësisht i panevojshem.

“Përgjigja e Autoriteti Kontraktues për pikat e lartëcekura ka qenë:

Tek aneksi nr.7 AK ka kërkuar qe OE duhet të posedoje ose te marre me qera te gjitha këto mjete si më poshtë:

Pra, ne i kemi elaboruar edhe më lartë sa i përket listes se pajisjeve tek pretendimi nr. 4. Pika II te ANEKSI 7 , Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve nr 1,2,5 dhe 6, sasia kaq e madhe eshte e

panevojshme, sepse, e kufizojne konkurrencen, kjo është një kërkesë që e favorizon vetëm një OE, kështu që e ulë konkurrencën dhe se diskriminohen Operatorët tjere ekonomik, sepse të gjitha këto mjete janë të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit, sepse si është e mundur si për LOT 1 ashtu edhe për LOT 2 sasia e ketyre mjeteve të jete e barabarte kur dihet mire se LOT 1 është rreth 3 herë më i madh se LOT 2. Sa për informatë, po ju informojmë se në asnjë aktivitet të mëhershëm të prokurimit nuk janë kërkuar këto mjete dhe se ne dyshojmë se ky aktivitet i prokurimit e favorizon një Operator ekonomik.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “ALLTON SH.P.K” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 7, 8, 27 dhe 51 të LPP-së. Duke propozuar që të **aprovohet** si e bazuar ankesa jonë Operatorit Ekonomik: “Allton” SH.P.K. në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **“Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – LOTO 1 dhe LOTO 2”** me nr. te prokurimit: **616-24-1099-2-1-1** te iniciuar nga Kuvendi Komunal Prishtine. **Korrigjohet Dosja e tenderit nga Autoriteti Kontraktues per aktivitetin: “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – LOTO 1 dhe LOTO 2” me nr. te prokurimit: 616-24-1099-2-1-1.**

Përgjigja e AK ne ndaj kërkesës për rishqyrtim: “Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se tanimë janë publikuar të gjitha sqarimet e nevojshme lidhur me secilin prej pretendimeve në kërkesën për rishqyrtim mirëpo edhe është bërë korrigjimi i dosjes së tenderit aty ka qenë nevoja. Sidoqoftë, përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Prandaj sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore. Rrjedhimisht njësia kërkuese ka dërguar përgjigjet si në vijim:

Për pretendimin me nr. 1 "Sqarimet: OE duhet të kete një menagjer me pervoj pune se paku 5 vite me page prej 500 euro te perfshiet ne analizen financiare dhe te deshmohet me trust dhe kontrata te punes. Vetfakti qe kerkohet trusti dhe kontrata e punes do të thotë se është kriter që duhet plotësuar nga OE qe menaxheri te kete 5 vite pervoj pune me page minimum 500 bruto euro. Sqarimet: OE duhet me dorezimin e Ofertes te paraqes analizen financiare me pagen bruto 400 euro per puntor sipas ATK-se dhe pushimet vjetore sipas ligjit te Punes dhe materialin higjienik. Paga 400 euro me te gjitha taksat e ligjet e ATK kur te kalkulohen te gjitha vie te vlera 400 euro për puntore".

Ndërsa sa i përket pretendimit me nr. 2, tanimë janë publikuar sqarimet e nevojshme dhe janë bërë korrigjimet në dosjen e tenderit pasi që ky pretendim është i bazuar.

Për pretendimet me nr. 3, 4 dhe 5 "Sqarimet: Të gjithn paisjet teknike për realizimin e këtij projekti janë kërkuar nga njësia kërkuese andaj edhe mbeten ashtu si janë. Gjithashtu ju njoftoi se janë instiucione edukativo arsimore të cilat katet e tyre jane mesatare esllte 3:20-3:40 (tre kate) andaj duhet patur parasysh se jo lehtesisht Ilga te gjitha anet e institucionit mundet me e Ilogarit lartetin nga toka vertikalisht e deri te pika me e larte sepse ne disa raste duhet Ilogarit edhe distancen nga oborri apo afersin qe mundet te ofrohet paisja/mjeti I punes afër sepse nuk ka mundesi te hysh ne afersi te objektit nga gjelbrimi , rrethoja prandaj kerkohen keto dimensione ne menyre qe te oforhet sherbimi dhe te gjitha keto kerkesa jane te institucioneve edukativo arsimore ku njesia e kerkeses I ka adresua

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur vetëm pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si pjesërisht e bazuar.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 08.04.2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 299/24, ndërsa me datë 13.08.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0299 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe të gjeturat tjera në këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **aprovohet si pjesërisht të bazuara** (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet si më lartë), dhe të njëjtin tender rekomandon që autoriteti kontraktues të bëjë përmirësimin e dosjes së tenderit dhe zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave konfirmo **nenit 53.7** të LPP-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, “Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë përgjigje rreth rekomandimit të ekspertit. Ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues ”

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “ALLTON SH.P.K” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0299 ka vlerësuar si në vijim:

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1: “Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE ‘‘ALLTON’’ SH.P.K ka qenë: “Keni kërkuar një listë të kontratave të realizuara duke plotësuar aneksin 4 të dosjes së tenderit, mos është fjala për aneksin 6, sepse aneksi 4 është Siguria e Tenderit. Gjithashtu, keni kërkuar tek kriteret, pika 7, kërkesa juaj është që Operatori Ekonomik me rastin e dorëzimit të ofertës të paraqes një Analizë Financiare me pagë bruto 400€ për punëtorë sipas ATK dhe pushimeve vjetore sipas Ligjit të Punës. Pyetja jonë është se a është fjala për Ligjin e Punës nr.03/L-212.”

Sa i përket këtij pretendimi AK as që u marrë me këtë pretendim, nuk kemi marrë asnjë përgjigje. AK ka kërkuar një kontratë të realizuar, duke kërkuar plotësimin e aneksit 4 të dosjes së tenderit, ndërsa ne e kemi pyetur se mos është fjala për aneksin 6 sepse aneksi 4 është Siguria e Tenderit. Gjithashtu, AK tek kriteret pika 7 ka kërkuar një analizë financiare me pagë bruto 400€ për punëtorët sipas ATK dhe pushimeve vjetore sipas Ligjit të Punës. Pyetja jonë ka qenë se a është fjala për Ligjin e Punës nr.03/L-212. Pra, në këtë pretendim nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit në këtë aktivitet të prokurimit, AK ka publikuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit duke zbatuar procedurë e hapur, lloji i kontratës: Kontratë Publike Kornizë – Shërbime me një OE ekonomik, vlera e parashikuar e kontratës: LOT 1: 1,107,400.00 €, LOT 2: 388,800.00 €. Sa herë që paraqiten probleme për autoritetin kontraktues, ato duhet të analizohen në mënyrë sa më detale nga stafi përgjegjës për atë që është e mundur në mënyrë, që të

përmbushim nevojën apo te zgjidhim problemin e autoritetit kontraktues sa me mire, ne mënyrë me efikase dhe te drejt te shfrytëzimi te fondeve publike, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, duke përcaktuar kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin e dhënies. Përgjegjësia mbi përzgjedhjen e kriterëve te përzgjedhjes dhe kriterëve te dhënies, bie apo është përgjegjësi mbi/e autoritetin kontraktues. Është në diskrecion të Autoriteti kontraktues vendos se cila kriterë te përzgjedhës do të përcaktohen, ne mënyrë qe OE te interesuar kërkohet te dorëzojnë ne mënyrë që të kualifikohen duke plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate, mirëpo te gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet te jene drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë, sipas nenit 51 par. 1 te LPP-se, po citoj: “Autoriteti kontraktues duhet të theksojë në njoftimin e kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret e përzgjedhjes që një operator i interesuar ekonomik duhet ti përmbushë për tu konsideruar si i kualifikuar: (i) në rast të procedurave të hapura dhe procedurave të kuotimit të çmimit për dhënien e një kontrate; Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriterë të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji”.

Gjithashtu, Eksperti shqyrtues sqaron, se ekziston rreziku i madhe për AK të hyje ne një kontratë me një operatore ekonomik i cili nuk ka kapacitet profesionale ne përmbylljen e kontratës për autoritetin kontraktues ne harmoni me specifikimet teknike dhe kushtet tjera, për implementimin me suksese te kontratës ne këtë aktivitet te prokurimit, andaj autoriteti kontraktues duhet te analizoj dhe te sigurohet qe te mos ndodhet para nënshkrimit te një kontrate e cila nuk e zgjidhe problemin e autoriteti kontraktues apo nuk përmbush nevojën e autoriteti kontraktues edhe pse këtë gjë autoriteti kontraktues, duhet te dije me se miri, sepse ata janë te obliguar ti njohin dhe ti përmbushin nevojat për autoritetin kontraktues, ne pajtim me dispozitat ligjore te LPP-së, ne atë mënyrë, që aq sa është e mundshme te gjitha dokumentet qe duhet te dorëzojnë operatorët ekonomik me dosjen e tenderit, te kufizohen vetëm ne aq dokumente, sa është i nevojshëm për ti lejuar autoriteti kontraktues qe te verifikoj se operatori ekonomik, i përmbush kriteret minimale te përzgjedhjes te saktësuar ne njoftim për kontrate dhe dosje te tenderit dhe qe janë ne pajtim me nenet 65-70 te LPP-se. Zyrtari i Prokurimit është përgjegjës për përgatitjen e dosjes se tenderit ose me fjale tjera ai/ajo është përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve te tenderit, kriterëve te përzgjedhjes, si dhe kriterëve te dhënies, ndërsa specifikimet teknike do te përgatiten nga struktura te specializuara ne çështjen qe do te prokurohet, brenda autoriteti te kontraktues (mirëpo, specifikat teknike, duhet të jenë në raport të drejt me kriteret e përzgjedhjes), si dhe nenit 17.12 te rregullorse Nr. 001/2022 per PP, po citoj: “Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e

kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shitesë. Veçanërisht, autoriteti kontraktues duhet të ketë parasyshë, kur përgatitet dosja e tenderit, që mos të ketë komunikime, diskutime ose negocime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve. Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike. Bazuar ne deklaratën detale mbi faktet dhe argumentet te OE ankues, qëllimin e këtij aktiviteti te prokurimit, vlerën e parashikuar ashu siç e parasheh neni 9 i LPP-së si dhe natyrën e kësaj kontrate ne zgjidhjen e problemit te autoritetit kontraktues, përmbushjen e nevojës se AK ne mënyrën sa me efikase ne arrijten e realizimit te këtij aktiviteti te prokurimit, pasi qe duke marr per bazë vleren e parshikuar për Lot 1 : për këtë AP vetëm për Pagat e punëtorëve me te gjitha kontributet e aplikushme në Republikën e Kosovë plus TVSH pa perfshi edhe pushimet vjetore sipas Ligjit te Punes dhe materialin shpenzues eshte: $140 \times 420 \text{ €} = 58,800.00 \text{ €} \times 18 \text{ muaj} = 1,058,400.00 \text{ €} \times 18\% = 1,248,912.00 \text{ €}$, ndersa AK ka planifikuar vlerene parashkikuar per AP per Lot 1: $1,107,400.00 \text{ €} \times 30\%$ (devijimi i lejuar sipas sqarimit nga AK te dates 08.03.2024) = $1,439,620.00 \text{ €}$. Lot 2 : për këtë AP vetem per Pagat e punetoreve me te gjitha kontributet e aplikushme në Republikën e Kosovë plus TVSH pa perfshi edhe pushimet vjetore sipas Ligjit te Punes dhe materialin shpenzues eshte: $51 \times 420 \text{ €} = 21,420.00 \text{ €} \times 18 \text{ muaj} = 385,560.00 \text{ €} \times 18\% = 454,960.00 \text{ €}$, ndersa AK ka planifikuar vleren e parashkikuar per AP per Lot 2: $388,800.00 \text{ €} \times 30\%$ (devijimi i lejuar sipas sqarimit nga AK te dates 08.03.2024) = $505,440.00 \text{ €}$, andaj pushimet vjetore dhe shpenzimet e materialit shpenzues po ashtu AK duhet te parashikohen te mbuloohen brenda kësaj vlere te parashikuar (mirepo materiali shpenzues ne këtë fazë është e pa mundur te vleresohet sepse këtë e percakton çmimi i tregut nga OE, mirepo AK duhet te parasheh dhe analizoj), konsideroj se AK nuk ka hartuar dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate ne pajtim te plotë me këto dispozita ligjore te LPP-së, po ashtu ketu duhet llogaritur edhe pagen dhe pushimin vjetor per menaxherin e kontrates e kontrates 500.00 € ku eshte specifikuar paga bruto, mirepo nuk eshte specifikuar se mund te angazhohet i njeiti per tek dy Lot-et apo duhet te angazhohet per secalin lot nga nje nje menaxher (si dhe kualifikimi i menaxherit)?!... Prandaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika janë pjesërisht të qëndrueshme.

Përgjigje në Pretendimi nr.2: “Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Gjithashtu tek pretendimi nr.4 pika kemi kerkuar: Tek lista e pajisjeve Aneksi 7, tek pika nr.2 keni kërkuar minimumi 40 fshesa elektrike, Makina per larjen e dyshmeve minimum 8 copa, trimera me derivate minimum 70 cope, kositese per kopsht me derivate minimum 30 ,sasia kaq e madhe e ketyre kërkesave eshte e pa nevojshme, duke pasur eksperince qe një kohë të gjatë me pastrimin e shkollave. Përveç kësaj ju lutem te specifikoni qartë sasinë e kërkuar tek ankesi 7. Nëse i referohemi vlerës se parashikuar te kontrates per lot 1 dhe lot 2 është totalisht e pakutueshme se si jane kërkuar keto sasia kur dihet se vlere e parashikuar per lot 2 eshte rreth 3

here me e vogël se sa vlera e parashikuar per lot 1 kurse sasitë janë kërkuar në numër të njejtë. Kjo pyetje vlenë për të gjitha sasitë e parapara tek aneski 7 i dosjes sepse nuk jane te specifikuara sa jane per LOTO 1 dhe sa jane per LOTO 2 kur dihet mire se LOTO 2 eshte rreth 3 here me i vogël se sa vlera e parashikuar per LOTO 1 duke u bazuar ne vleren e parashikuara ne DT. Kerkojme nga Paneli Shqyrtues i Prokurimit qe te detyroj AK qe te na e specifikoj per secilen Loto sasin e kerkuar pasi qe lotot nuk jane ne proporcion te barabart ne mes veti.

Pretendimi nr.4 pika 3 kemi kerkuar: “ Tek pika nr.7, keni kërkuar një kran me lartësi minimumi 30 metra, duke pasur parasysh se objektet shkollore maksimumi janë 2-4 kat, mendojmë se kjo kërkesë është shumë e lartë dhe kërkojmë nga ju që krani për pastrim të mos kufizohet në 30 metra por të jetë më i vogël. Siç verehet edhe kjo kerkese e dosjes paraqet kufizim te konkurrencës andaj kërkojm që kjo kërkesë ose të hiqet ose të zvoglohet minimumi i kerkuar në 20 metra sepse minimumi i kërkuar prej 30 metra sherben vetëm për objekte prej 14 kate e më lartë. Po ashtu kjo kërkesë eshte ne kundershtrim me nenin 51 te LPP-se andaj ose përshtatni me natyren e kontrates ose ta heqni krejtesisht si te tillë sepse objektet e shkollave maksimum janë 2-4 kate dhe lartësia prej (minimum 20 metrave) jo që është e mjaftueshme por teper e gjate.”

Pretendimi nr.4 pika 4 kemi kerkuar: “ Tek pika nr.8, keni kërkuar platformë apo pajisje ngjitëse për pastrimin e xhamave në lartësi minimumi 32 metra, me gjerësi deri 1.30 mpiheve minimum 7. Kjo kërkesë është komplet e panevojshme, sepse, pjesa më e madhe e shkollave janë maksimumi 2-4 kate. Pra, të gjitha dritaret që janë të parapara mund të pastrohen edhe me anën e kranit. Ju lutemi që këtë kërkesen ta heqni nga dosja pasi që është në kundershtrim me nenin 7 të LPP-së dhe favorizon vetëm një OE. Ju vë në dijeni se kerkesa 8 është plotësisht në kundershtrim me nenin 51 te LPP-se sepse është krejtsisht i panevojshem.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmimeve te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit ne këtë aktivitet te prokurimit, se AK me rastin e përgaditjes se dosjes se tenderit per kete aktivitet te prokurimit ku nenin 2.5 te FDT-së, ka lejuar qe OE/tenderuesi te ofertoj ne “Të gjitha pjesët” qe do te thotë se OE te interesuar mudn te ofertojn ne te dy (2) Lot-et apo vetem për njërin Lot, andaj duke marr per për bazë vleren e parashikuarm dhe natyren e ketij AP, autoriteti kontraktues është dashur te kete parasysh edhe nenin 7 par. 2 te LPP-së, ku thote: “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik”, sepse dosja e tenderit si dokumente themelore mbi te cilin OE/Tenderuesit pergaditin ofertat e tyre është dashur te sqarohet edhe lista e paisjeve për secalin lot veç e veç ne menyre qe OE /tenderuesit te kenë te qartë nese tenderojn vetëm për njërin Lot apo edhe nese tenderojn për te dy (2) Lot-et., sepse Lot-et nuk janë ne proporcion te

drejtë mes veti, po ashtu AK përcakton kriteret minimale për gjendjen ekonomike dhe financiare apo aftësinë teknike dhe profesionale, duhet të merr parasysh që përmbushja e kërkesave minimale për Lotet për të cilat konkurron OE, përveç kësaj të analizoj dhe hulumtoj edhe një herë Aneksin 7 të FDT-së, në mënyrë që të hap konkurrencën mes OE dhe mos të kufizoj me kërkesa si p.sh. “platformë apo pajisje ngjitëse për pastrimin e xhamave në lartësi minimumi 32 metra, me gjerësi deri 1.30 mpiheve minimum 7”, pasi që duke marr për bazë përgjigjen në vendimin e datës 28.03.2024 në KpR të OE ankues ku e potenconi përgjigjinë nga një Njësia Kërkuese, po citoj: “Institucionet edukativo arsimore të cilat katet e tyre janë mesatare është 3:20 – 3:40 (tre kate)” lehtësisht konstatohet se $3 \times 3.40 = 10.20 \text{ m} \times 2 \text{ (dyfishi)} = 20 \text{ m}$ po ashtu, nëse i referohemi Aneksit 1 të FDT-së ankues nuk është specifikuar nga njësia kërkues se është e nevojshme kjo pajisje, andaj të respektohet në plotëni neni 7 i LPP-së, duke ulur kërkesat e pajisjeve teknik dhe duke sqaruar sasin dhe pajisjet e nevojshme për secilin Lot veq e veq në mënyrë që OE/tenderuesit, të kenë të qarta dhe të mos ketë nevoj për sqarime të metutjeshme, duke rritur konkurrencën dhe transparencën lidhur me këtë AP. Prandaj duke u bazuar në këto fakte analizës së dokumentacionit të prezantuar dhe analizës së mësipërme, pretendimet e palës në ankesë, në këtë pikë janë të qëndrueshme.

Përgjigje në Pretendimi nr.3: “Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Autoriteti Kontraktues është dashur t’a pezulloje aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – LOTO 1 dhe LOTO 2, me nr. të prokurimit: 616-24-1099-2-1-1 dhe nr të brendshëm 616 -24-09-2-1-1, me rastin e kërkesës për rishqyrtim, mirëpo AK nuk e ka bërë pezullimin e aktivitetit të prokurimit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim me datë 24.03.2024 në ora: 21:00 min. përmes platformës elektronike e-prokurim në pajtim me nenin 108/A par. 1 të LPP-se. AK me datën 28.03.2024 në ora 14:12 min. Ka ngritur vendimin mbi aprovimin e pjeshem të KpR të parashtruar nga OE ankues, mirëpo me këto rast AK ka nuk ka respektuar nenin 108/A par. 2 të LPP-se, po citoj: “Dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar”, AK brenda afatave ligjore i ka dhënë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim OE ankues, edhe perkunders se nuk e ka palzulluar AP sigurisht për shkak të vllimit të punëve, duke e ngatrruar edhe titullin e AP në vendimin mbi aprovimin si pjesërisht e bazuar të KpR. Prandaj duke u bazuar në këto fakte analizës së dokumentacionit të prezantuar dhe analizës së mësipërme, pretendimet e palës në ankesë, në këtë pikë janë pjesërisht të qëndrueshme.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, nuk ka respektuar nenin 7, 27 dhe 51 të LPP-së, andaj Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plotë me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ALLTON SH.P.K” Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertes mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ALLTON SH.P.K” janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – LOTO 1 dhe LOTO 2” **me nr. të prokurimit: 616-24-1099-2-1-1.**

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve

ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, të cilave ja ka falur besimin, atëherë është gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjeserisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – LOTO 1 dhe LOTO 2” me nr. të prokurimit: 616-24-1099-2-1-1, të korrigohet dosja e tenderit. Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rrjedhimisht paneli shqyrtues konstaton që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjeserisht e bazuar, AK të bëjë përmirësimin e dosjes së tenderit dhe zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave konfirmo **nenit 53.7** të LPP-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - ALLTON SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: